

MBI AUDITIMIN E USHTRUARNË DEGËN E DOGANËS ELBASAN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës Elbasan, me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor dhe veprimtarinë ekonomike e financiare” për periudhën 01.01.2013 - 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 198, datë 31.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 940/7, datë 07.01.2015 Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Oligert Kume Kryetar i Degës së Doganës, Elbasan dhe zj. Elisa Spiropali, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1-Nga auditimi u konstatua se, nga Dega Doganore Elbasan, nuk është hartuar plani strategjik vjetor, ku të përcaktohen objektivat kryesore, nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk është hartuar plani i veprimeve për arritjen e objektivave, nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik të njësisë së degës doganore, nuk është miratuar një sistem rregullash specifike për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të njësisë, nuk janë miratuar akte të brendshme administrative për të siguruar ngritjen dhe zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm, të njësisë së degës doganore, *trajtuar më hollësisht në faqet 48-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* që Dega e Doganës Elbasan, të marrë masa të hartojë planin strategjik vjetor, të hartojë strategjinë e menaxhimit të riskut, të hartojë planin e veprimeve për arritjen e objektivave, të ngrihet grupi i menaxhimit strategjik ku të kryesohet nga titullari, të miratojë aktet e brendshme administrative për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe për zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm bazuar në kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

2-Nga auditimi u konstatua se, nga Dega Doganore Elbasan, nuk është kryer inventarizimi i një pjese të pasurisë së institucionit, për inventarin ekonomik, si pajisje e orendi, mjete transporti, materiale objekte inventari në përdorim të personave materialisht përgjegjës, të evidentuar sipas kartelave personale të magazinës, *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 46-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, Për këtë është rekomanduar* që Dega e Doganës Elbasan, të marrë masa të kryejë inventarizimin e pasurisë së institucionit bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, pika 1, 2.

Deri më 31.01.2015

3-Nga auditimi u konstatua se, nga Dega Doganore Elbasan dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, nuk kanë evidentuar vjetërsinë e punës për çdo person për efekt pagese, të pakësuar për vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 47-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është*

rekomanduar që Dega e Doganës Elbasan, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Tiranë, të marrë masa për të evidentuar vjetërsinë e punës për çdo person për efekt pagese, duke përjashtuar vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie, bazuar në kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë,institucionet në varësi të Ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit ”, i ndryshuar pika ½ shkronja “b”.

Në vijimësi

4-Nga auditimi u konstatua se, nga Dega Doganore Elbasan, nuk është cilësuar në fletë hyrjen e magazinës, çmimi për çdo artikull dhe vlera përkatëse e llogaritur në total, në rastet e konfiskimit dhe sekuestrimit të mallrave dhe materialeve të ndryshme, gjatë magazinimit, në 11 vendime për kundërvajtje administrative të subjekteve të ndryshme gjatë vitit 2013, *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 32-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* që Dega e Doganës Elbasan të marrë masa për vendosjen e çmimit dhe vlerën përkatëse për çdo artikull, në fletë hyrjet e magazinës, në rastet e konfiskimit dhe sekuestrimit të mallrave dhe materialeve të ndryshme, gjatë magazinimit, në 11 vendime për kundërvajtje administrative të subjekteve të ndryshme, bazuar në kërkesat dhe përcaktimet e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 37.

Në vijimësi

5-Nga auditimi u konstatua se, nga Dega Doganore Elbasan, nuk janë dorëzuar në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Elbasan, mallrat e sekuestruara të cilat janë bërë hyrje në magazinën e degës doganore, *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 32-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* që Dega e Doganës Elbasan të marrë masa për të dorëzuar në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Elbasan, mallrat e sekuestruara të cilat janë bërë hyrje në magazinën e degës doganore, bazuar në kërkesat e VKM nr. 286, datë 30.05.1994 “Për administrimin e sendeve që kalojnë në dobi të shtetit nga kundërvajtjet administrative” me ndryshime, pika 5.

Në vijimësi

6. Nga auditimi u konstatua se subjekti me Nipt me praktikat doganore me numër : R 4327 dt. 30.03.2013, R 11050 dt.12.08.2013, R 11971 dt.31.08.2013, R 14107 dt. 16.10.2013, R 15733 dt.15.11.2013, R 17621 dt.26.12.2013, ka importuar nga Gjermania me origjinë gjermaninë artikullin mish pule, kodi tarifor 02071410 (që sipas NK të Mallrave , Kapitulli 2 i përket emërtimit të artikullit mish dhe të brendshmet e ngrënshme, të shpendëve, prerje dhe të brendshme, të ngrira, pa kocka). Si bazë vlerësimi është përdorur çmimi i referencës me 0.9 euro/kg CIF. Sipas të dhënave të disponueshme çmimi i artikullit mish pule është 1.17 euro/kg FOB . Nga vlerësimi me 0.9 euro/kg CIF nga 1.17 euro/kg FOB (Sipas të dhënave të disponueshme), rezulton një diferencë në detyrimet doganore në total për shumën 2,357,570 lekë. Nga D.D.Elbasan është paraqitur observacioni me nr. 394, datë 16.12.2014 dhe bashkangjitur Fletë-Analiza e Laboratorit Doganor me nr. 27760/1, datë 26.11.2014 (pa firmë e pa vulë laborator), ku pretendohet se artikulli i importuar është MDM dhe se vlerësimi është bërë korrekt. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të vërtetohet nëse mostrat e dërguara në

laborator janë identike me ato të deklaratave të mësipërme *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 14-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* që Dega e Doganës Elbasan të dërgojë për investigim të mëtejshëm nga Departamenti Operativ Hetimor në Drejtorinë e Përgjithëshme të Doganave, praktikat doganore me numër: R 4327 dt. 30.03.2013, R 11050 dt.12.08.2013, R 11971 dt.31.08.2013, R 14107 dt. 16.10.2013, R 15733 dt.15.11.2013, R 17621 dt.26.12.2013 dhe të meren masat përkatëse sipas Kodit Doganor.

Deri më 31.01.2015

7. Nga auditimi u konstatua se dosjet e investigimit për subjekte të ndryshme, me qëllim pranimit e çmimit me transaksion në përlogaritjen e vlerës doganore nuk janë të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm, praktikat doganore nuk janë shoqëruar me procesverbal mbi vlerësimin, *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 14-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* që nga Dega e Doganës Elbasan, të merren masa që praktikat doganore, të pranuar me transaksion në përcaktimin e vlerës për qëllime doganore, të argumentohen me procesverbale vlerësimi të indikatorëve në zbatim të neneve 285, 286, 287 e vijim të Kodi Doganor, si dhe të udhëzimin nr. 25, datë 13.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes më të dhëna të disponueshme dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre” pika 6, si dhe në zbatim të Kodit Doganor nenet 34 “vlera e transaktuar” dhe 35/a “vlera e mallrave identike”.

Në vijimësi

8. Nga auditimi u konstatua se dokumentacioni shoqërues i praktikave doganore, të pranuar për vlerësim nga administrata doganore, janë dokumente fotokopje si: fatura e shitjes, CMR, deklarata e eksportit, certifikata e origjinës, lista e paketimit, *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* që nga Dega e Doganës Elbasan, të merren masa për ndalimin e menjëhershëm të përdorimit të dokumenteve shoqëruese të praktikave doganore që paraqiten për zhdoganim nga operatorët ekonomik dhe pranohen për vlerësim nga administrata doganore, në formën dokumente fotokopje të tilla si fatura e shitjes, CMR, deklarata e eksportit, certifikata e origjinës, lista e paketimit në raste të veçanta edhe Euro 1, veprime këto që bien në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Dispozitat Zbatuese” dhe udhëzimi nr. 25, datë 30.11.2007, i Ministrit të Financave.

Në vijimësi

9. Për mallrat të cilat nuk kanë të dhëna të disponueshme si dhe për mallrat e përdorura, nuk është nxjerrë urdhër nga Dega Doganore për miratimin dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit, ku për vendimet e marra nga ky komision duhej të ishte njoftuar menjëherë DPD, *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 32-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* që nga Dega e Doganës Elbasan, të nxirret menjëherë urdhri i brendshëm për funksionimin e Komisionit të Vlerësimit Doganor, për të vlerësuar mallrat për të cilët nuk kanë të dhëna të disponueshme të dërguar nga DPD, si dhe për mallrat e përdorura.

Në vijimësi

10. Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se paraqiten një numër tranzitësh të mbyllur me vonesë e jashtë kohës limitit të mbërritjes në destinacion, nuk është paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për vonesat nga ana e Degës Doganore Elbasan dhe nuk janë aplikuar

penalitetet përkatëse, për vitin 2013 u konstatua se: në 9 raste nuk janë aplikuar penalitetet përkatëse në shumën 2,586,000 lekë, *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 25-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* që nga Dega e Doganës Elbasan të merren masa për evidentimin e tranziteve të mbyllura me vonesë e jashtë kohës limitit të mbërritjes në destinacion, të përcaktohen e të vendosen penalitetet përkatëse sipas rasteve për vitin 2013.

Deri më 31.03.2015

11. Nga Sektori i Akcizës në Degës Doganore Elbasan ,vihet re se ka një numër të paktë kontrollesh nëpër subjektet e akcizës, nuk ka kontrole të inventarizimit të kapaciteteve prodhuese të lëndëve të para si bimë, sipërfaqe toke etj., *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 34-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* që të organizohet një kontroll mbi inventarizimin e kapaciteteve prodhuese të subjekteve në vend që merren me prodhimin e pijeve alkolike. Të kryhen kontrole periodike rutinë mbi procesin e mbledhjes dhe grumbullimit të lëndës së parë. Të rritet numri i kontrolleve për prodhuesit e produkteve të akcizës sidomos gjatë procesit të prodhim-përpunimit të produkteve.

Në vijimësi

12. Nga auditimin u konstatua se kontabiliteti i stokut përfshin hyrjen e lëndëve të para dhe deklarimin e hedhjes për konsum, duke mos patur evidentim të prodhimit në proces në fillim e në fund të periudhës, *trajtuar më hollësisht në faqet në faqet 34-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë është rekomanduar* që DD Elbasan, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të marrë masa të plota ligjore, organizative dhe teknike për kontrollin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të subjekteve të autorizuar të akcizës dhe të vijohet me plotësimin e dosjeve me dokumentacion. Të plotësohen deklaratimet e subjekteve prodhuese mbi inventarizimin e prodhimit në proces, lëndës së parë dhe produktit të gatshëm në ruajtje.

Në vijimësi

13. Duke qenë se vihet re një shtesë në vlerë dhe në numër të subjekteve debitore, borxh në përqindje të lartë në krahasim me të ardhurat e gjeneruara nga Dega Doganore Elbasan, *trajtuar më hollësisht në faqet 27-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, është rekomanduar* që të ndiqen të gjitha hapat ligjorë, për njoftimin e subjekteve debitor sapo të saktësohet dhe kontabilizohet detyrimi i papaguar, të përfundojnë në kohë të gjitha procedurat ligjore deri në arkëtimin e plotë të borxhit, në mënyrë të veçantë të arkëtohet ajo pjesë e borxhit, e cila është mbështetur me Urdhra Ekzekutimi nga Autoritetet Gjyqësore.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Dega e Doganës Elbasan, të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerë prej **6,256,353 lekë** si më poshtë :

1. Vlera **4.979.413 lekë**, nga 3 (tre) subjekte me statusin e magazinës fiskale prodhues të produkteve të akcizës, sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur, *trajtuar në faqet 34-37 të Raportit*

Përfundimtar të Auditimit, për mos llogaritje dhe vjelje të detyrimit të akcizës prej 1,111,613 lekë dhe penalitetit përkatës prej 3,867,800 lekë.

Deri më 31.03.2015

2. Vlera prej **287,500 lekë**, për subjektin [REDAKTUAR] me statusin e magazinës fiskale prodhues të produkteve të akcizës, *trajtuar në faqet 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*, për mos llogaritje dhe vjelje të shumës të garancisë së depozituar e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

Deri më 31.03.2015

3. Vlera prej **660,000 lekë**, për katër subjekte, sipas aneksit nr. 3 bashkëlidhur, *trajtuar në faqet 29-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*, për mos llogaritje të saktë të penalitetit, referuar vendimeve të marra nga Dega Doganore Elbasan.

Deri më 31.03.2015

4. Vlera prej **87,148 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] të *trajtuar në faqen 18 të Raportit të Auditimit* për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore sipas Kodit Doganor dhe udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 për artikullin autoveturë.

Deri më 31.03.2015

5. Vlera prej **79,999 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] me Nipt J62903303L në 1 rast, *trajtuar në faqen 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit* për mos llogaritje dhe mos arkëtim të Rentës Minerare sipas kërkesave ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” neni 40 pika 2, Ligjit nr. 10280, datë 20.05.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare të ndryshuar, VKM nr. 7, datë 04.01.2012 “Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Arkëtimin e Taksës së Rentës Minerare” dhe shkresës së Ministrisë Financave nr. 16365, datë 17.10.2012 “Për Miratimin e Vlerave Referuese sipas Normativave Teknologjike të Produkteve që Përdorin Minerale nga Komisioni AD HOC mbi Rentën Minerale”.

Deri më 31.03.2015

6. Vlera prej **50,000 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] me Nipt [REDAKTUAR] në 1 rast, *trajtuar në faqen 49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*, mbështetur në Ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet neni 275, pika 1 për shkelje që i referohen nenit 256, paragrafi 2.

Deri më 31.03.2015

7. Vlera prej **112,293 lekë** nga [REDAKTUAR], ish-Kryetar i Degës Doganore Elbasan për përdorimin e automjetit jashtë nevojave funksionale të degës doganore, *trajtuar në faqet 44-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit* jo në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me Rregulloren e

brendshme nr. 14443/1 dhe 14443/2 prot. datë 12.09.2012 "Për përdorimin e automjeteve të sistemit doganor", neni 3 pika 1 dhe 2, neni 5 pika 5.

Deri më 31.03.2015

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil ", i kërkojmë Drejtores së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore Elbasan, që në vlerësimin e shkeljeve , sipas pikës 1 germa "b" të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin e dhënien e masave përkatëse disiplinore sipas nenit 58, germa " c ", ***"pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet "***, për nëpunësit civil si më poshtë:

1. [REDAKTUAR] me detyrë doganier akcize : Për shkelje të Udhëzimit të DPD , Nr. 2, datë 27.09.2012 neni 75 "Mbi përcaktimin e masës së garancisë për magazinat fiskale të prodhimit përpunimit, stokimit dhe në lëvizjen e mallrave të akcizës nën pezullim", pika 3 ,ku në tabelën 2 përcaktohet se: masa e garancisë duhet të jetë norma 15 % për Prodhuesit/përpunuesit e produkteve të akcizës të cilët janë recitivist (*me shkelje të përsëritur më shumë se 1herë*). Në kushtet e penalizimit në fushën e akcizës, llogaritja e garancisë për subjektin [REDAKTUAR] duhet të bëhet me detyrim të garancisë shtesë prej **10,350,000 lekë**, pasi subjekti ka marrë penalitet në fushën e akcizave me anë të vendimeve nr. 84 dhe 85 për mos deklaram të destinacionit të firove.

2. [REDAKTUAR] me detyrë ish-doganier akcize në DD Elbasan dhe aktualisht doganier në DD Tiranë : Për shkelje të udhëzimit nr. 2, datë 27.09.2012 "*Mbi përcaktimin e masës së garancisë për magazinat fiskale të prodhimit, përpunimit, stokimit dhe në lëvizjen e mallrave të akcizës nën pezullim*".Për subjektin [REDAKTUAR] është bërë penalizimi me vendim nr. 115, dt .04.09.13 për keqklasifikim tarifor, pa efekte në fushën e akcizës si dhe nr. 220, dt. 31.12.2013, për keqklasifikim, pa efekte në vlerë në fushën e akcizës. Garancia e llogaritur është llogaritur në 143,750 lekë, duke përdorur normën 5 %, me shkresë nr. 90 prot.dt 07.10.2013. Në kushtet e penalizimit në fushën e akcizës në mënyrë të përsëritur, një herë llogaritja e garancisë duhet të bëhet me 15 %, ose 431,250 lekë, llogaritur më pak për shumën **287,750 lekë** .

3. [REDAKTUAR] me detyrë doganiere regjimesh : Për veprime në kundërshtim me ligjin Nr.8449, datë 27.01.1999 dhe "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", neni 287/2 ku citohet "*Kur, në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum, për të përcaktuar shumën e saj duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm: .. f) nëse i njëjti shkelës ka kryer të njëjtën shkelje në mënyrë të përsëritur*". Për subjektin [REDAKTUAR] që ka kryer shkelje të përsëritur, ka aplikuar penalitet minimal me efekt 150,000 lekë, për subjektin [REDAKTUAR] që ka kryer shkelje të përsëritur, ka aplikuar penalitet minimal në kundërshtim me nenin 287/2 të ligjit Nr.8449, datë 27.01.1999 dhe "Kodi Doganor i RSH-së", me efekt 150,000 lekë.

4. [REDAKTUAR] me detyrë doganier në kontroll aposterior : Për veprime në kundërshtim me ligjin Nr.8449, datë 27.01.1999 dhe "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", neni 287/2 ku citohet "*Kur, në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një*

*maksimum, për të përcaktuar shumën e saj duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm... f) nëse i njëjti shkelës ka kryer të njëjtën shkelje në mënyrë të përsëritur". Për subjektin [REDAKTUAR] që ka kryer shkelje të përsëritur, ka aplikuar penalitet minimal me efekt **70,000 lekë**, Për subjektin [REDAKTUAR] që ka kryer shkelje të përsëritur, ka aplikuar penalitet me efekt **140,000 lekë**.*

5. [REDAKTUAR] me detyrë doganier kontrolli fizik: Për veprime në kundërshtim me ligjin Nr.8449, datë 27.01.1999 dhe "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", neni 287/2 ku citohet "*Kur, në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum, për të përcaktuar shumën e saj duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm... f) nëse i njëjti shkelës ka kryer të njëjtën shkelje në mënyrë të përsëritur". Për subjektin [REDAKTUAR] që ka kryer shkelje të përsëritur, ka aplikuar penalitet minimal me efekt 150,000 lekë.*

-Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për ish-punonjësit e poshtë cituar nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi doganor:

1. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-Kryetar Degës Doganore
2. [REDAKTUAR] ish drejtor i Departamentit të Akcizës në DPD
3. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjëse Sektori të Regjimeve
4. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish doganier peshore / pikë kontrolli,
5. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish doganiere peshore /pikë kontrolli

Për z. [REDAKTUAR] me detyrë ish doganier i regjimeve për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë pasi për këto mangësi nga DPD është marrë masa disiplinore ulje në detyrë nga doganier i regjimeve ekonomike në doganier, peshore pikë kontrolli e për pasojë ulje në kategori e pagë.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Aqif Klosi, p/grupi, Edvin Stefani dhe Hekuran Avdulaj, u mbikëqyr nga Kryeauditues z. Albert Thoma, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës, Elbasan nuk ka kthyer ende përgjigje për masat e marra në zbatim të rekomandimeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT